REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I NDËRMJETËSIMIT TË DIALOGUT DOKTRINAR NË NDËRTIM

Nr./Br. 201/17
Data/Datum 30.06.2017

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: **KOMUNA E GJAKOVËS**
(Shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **632 17 1795 521**
dhe nr të brendshëm 632 17 019 521
(Shëno numrin e Aktivitetit të Prokurimit)

Sa i përket tenderit për **Rrënimi – Ekzekutimi i objekteve të ndërtuara pa leje, ndërtime ilegale dhe shërbime tjera**
(Shëno titullin e kontratës si në Dosjen e Tenderit)

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

NPSH "Eltoni Com" & "Hidro Project Shpk"
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. "Rezistenca" - Madanaj
(Adresa)

Gjakovë *(Vendi)* **50000** *(Kodi postar)*

(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Blerim Islamaj
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

(Adresa elektronike)

30.06.2017
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

N.P.SH. "ELTONI COM" 601586304 MADANAJ-GJAKOVË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [X] Jo [ ]

Hapja publike është bërë më datën 22.05.2017 në ora 14.00. Në hapje publike ishin të pranishëm komisioni për hapje publike dhe pesë përfaqësues të kompanive konkurruese. Gjatë këtij procesi nuk ka pasur ndonjë vërejtje.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po [X] Jo [ ]

AK na ka dërguar njoftimin si tenderues i pasuksesshëm më datën 14.06.2016 ku njëkohësisht na ka njoftuar edhe me rezultatin e vlersimit duke treguar edhe fituesin e perzgjedhur te ketij tenderi.
Ne si palë e pakënaqur me vendimin e AK, në afatin e rregullt ligjor dhe atë me datën 19.06.2017 kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim të vendimit për dhënjen e kontratës OE "Berisha Company". Kërkesa është dorëzuar në Komunën e Gjakovës. Më datën 22.06.2017 kemi pranuar Vendimin e AK mbi shqyrtimin e kërkesës tonë. Me këtë vendim AK ka hedhur poshtë si të pa bazuar kërkesën tonë për rishqyrëtim.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK ka shkelur Nenin 59 të LPP-së Nr. 04/L-042 i amamndamentuar,
AK shkelë edhe nenin 7 të LPP-së
AK ka shkelur Nenin 72 të LPP-së Nr. 04/L-042 i amamndamentuar,
AK ka shkelur nenin 108/A të LPP-së Nr. 04/L-042 i amamndamentuar,

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pas qasjes në dokumentacionin e tenderit dhe verifikimin e të gjitha dëshmive kemi vërejtur që AK ka bërë shkelje të LPP-së dhe rregulloreve tjera gjatë procesit të vlerësimit, sqarimit dhe përzgjedhjes së OE fitues. Shkeljet kanë të bëjnë si më posht:

AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së dhe Nenin 41 të RUOPP-së sepse gjatë vlersimit të tenderëve nuk i ka aplikuar dhe respektuar kërkesat që vet i ka përcaktuar në dosjen e tenderit përkatësisht tek pika 9.1 dhe 9.2 të FTD-së.
Këto shkelje kanë të bëjnë me kërkesën që OE duhet të dëshmojnë se kanë kryer së paku tre kontrata të natyrës së gjajshme e të cilat OE i shpallur fitues nuk i posedon.
OE "NTP Berisha Company" ka ofruar shumë dëshmi për kontrata të përfunduara por të gjitha i ka në fushën e ndërtimeve të ulëta që nuk duhet konsiderohen si kontrata të ngjajshme me natyrën e këntratës që synon ta lidhë AK. Rrënimet e objekteve kërkojnë një përvojë ekzakte në fushën e njëjët pasi që janë punë shumë të ndërlikuara dhe të përcjellura me rreziqe gjatë ekzekutimit. Mungesa e një përvoje të tillë mundet me shkaktu dëme materiale, krijon rrezik për kalimtarët e po ashtu rrezikon vetë stafin punues të OE. Të barasvrersosh një kontratë për asfaltim me një kontratë të rrënimit të kontrolluar të një objekti P+4 e më shumë etazha është e papranueshme si në aspektin ligjorë e po ashtu edhe në aspektin teknik. Prandaj mendojmë se AK pa të drejt e pranon plotësimin e këtij kushti nga OE i shpallur fitues duke shkelur nenin 59 të LPP dhe duke ju shmangur kërkesave të veta nga FTD-ja. Vetë fakti që kërkon sigurim të punëtorëve dhe pajisje me mjete të sofistikuar mbrojtëse tregon për seriozitetin dhe rrezikun e punës gjatë këtyre rrënimeve. Andaj si ka mundësi që këtë kontratë ta kryej një kompani që nuk ka kryer as edhe një punë të vetme të kësaj natyre. (*Shiko dëshmit e bashkangjitura*)
Kërkesë tjetër nga pika 9.1 dhe 9.2 e FTD ka qenë se OE duhet të kenë së paku 5 punëtor dhe plus një Inxhinier të Diplomuar të Ndërtimtarisë dhe një Gjeodet.
Për stafin është kërkuar që të janë të punësuar në kompani ose të kenë kontratë për angazhim në projektin në fjalë. OE "NTP Berisha Company" ka ofruar një listë të nënshkruar dhe vulosur të punëtorëve si dhe një dëshmi nga ATK-ja e vitit 2014 ku shihet se i ka në listën e pagave si të punësuar primar me përjashtim të njërit që figuron si i